



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

RREGULLORE
E
BASHKËPUNITIT TË STUDENTËVE ALUMNI
ME
UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI” VLORE

**Miratur me Vendim Nr. 65 të Senatit Akademik të Universitetit ‘Ismail Qemali’
datë 26.06.2025**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

KREU I

DIZPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullore e Alumni-t hartohet në bazë të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"

Neni 2

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë marrëdhënien dhe bashkëpunimin ndërmjet Universitetit të Vlorës "Ismael Qemali" (në vijim: UV) dhe rrjetit të ish-studentëve (Alumni).

Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë përmes Sektorit të Karrierës, Shërbimit të studentëve dhe Alumnit, synon të krijojë një mjedis gjithëpërfshirës që promovon barazinë, vlerëson diversitetin dhe ruan dinjitetin e të gjithë anëtarëve të komunitetit universitar.

Kjo rregullore zbatohet në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Sektori i Alumnit, duke përfshirë ngjarjet, komunikimet dhe përfitimet e ofruara për alumnit dhe mbështetësit. Rregullorja synon krijimin, zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve të vazhdueshme dhe të frytshme midis Universitetit "Ismael Qemali" Vlore dhe alumnit të tij, duke mundësuar:

- Mbështetjen profesionale dhe sociale të alumnit,
- Përfshirjen aktive të alumnit në jetën akademike dhe zhvillimin institucional,
- Promovimin e vlerave dhe identitetit të universitetit në komunitetin e gjerë.

Neni 3

Përkufizime

- *Alumni:* Ish-studentë të universitetit, të diplomuar ose që kanë përfunduar cikle studimi.
- *Marrëdhënie:* Komunikimi, bashkëpunimi, aktivitetet, shërbimet dhe përfitimet e ndërsjella midis universitetit dhe alumnit.
- *Platforma e alumnit:* Mjedisi online i krijuar për komunikim, regjistrim, shpërndarje informacioni dhe rrjetëzim midis alumnit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

KREU II

PARIMET DHE STRUKTURAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 4

Objektivat e marrëdhënieve me alumnit

Bashkëpunimi me Alumni-n synon:

1. Mbajtjen e kontakteve me ish-studentët e UV-së (Alumni);
2. Nxitjen e bashkëpunimit profesional, shkencor dhe social, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet akademike, shkencore dhe kulturore të universitetit;
3. Krijimi e mundësive për trajnime, punësim, mentorim dhe zhvillim karriere.
4. Mbështetjen e aktiviteteve humanitare, kulturore dhe sportive me pjesëmarrjen e alumnit.
5. Sigurimin e mbështetjes së tyre në procesin e mentorimit dhe karrierës për studentët aktualë;
6. Promovimin e suksesit të tyre profesional si dëshmi e cilësisë së diplomave të UV-së.
7. Promovimin e alumni si ambasadorë të universitetit në komunitet dhe tregun e punës.

Neni 5

Struktura e rrjetit Alumni

1. Rrjeti Alumni është një organizim joformal, por i strukturuar, që përfaqëson interesat e ish-studentëve të UV-së.
2. Koordinimi i marrëdhënieve dhe database i kontakteve dhe aktiviteteve të tyre bëhet nga Sektorit të Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumnit (SKSSA) në Universitetin "Ismail Qemali". Ky Sektor është përgjegjës për:
 - Mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave të alumnit,
 - Organizimin e aktiviteteve dhe eventeve,
 - Menaxhimin e platformës dixhitale të alumnit,
 - Përgatitjen e raporteve vjetore për aktivitetet dhe bashkëpunimet me alumnit.

Neni 6

Anëtarësimi

1. Anëtar i rrjetit Alumni mund të jetë çdo ish-student i diplomuar në UV.
2. Anëtarësimi është vullnetar, sipas formatit të shtojcës 1.
3. Anëtarësimi në rrjetin Alumni bëhet nëpërmjet regjistrimit online në web-site e UV.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

4. Informacioni për studentin (alumni), sipas Shtojcës 1, merret nga SKSHSA në momentin kur ai/ajo të tërheq diplomën ose në çdo rast tjetër që paraqitet pranë Sekretarisë mësimore të UV.

Neni 7

Mënyrat e komunikimit me alumnit

1. *Databaza e alumnit* – do të jetë baza kryesore për komunikim. Ajo mbahet nga SKSSA dhe Sektori i Kurrikulës dhe Statistikave dhe duhet të përmbajë:
 - Emrin dhe kontaktet (email, telefon),
 - Informacion profesional (puna, karriera, pozicioni aktual),
 - Preferencat për mënyrën e komunikimit.
2. Universiteti obligohet të krijojë dhe mirëmbajë një platformë online të dedikuar për alumnit, e cila do të përmbajë:
 - Regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të alumnit.
 - Forum dhe grupe diskutimi për rrjetëzim dhe bashkëpunim.
 - Njoftime për ngjarje, trajnime, punësime dhe oferta të ndryshme.
 - Seksione për mentorim dhe këshillim karriere.

Platforma do të jetë e aksesueshme falas për të gjithë alumnit.

3. Komunikimi do të bëhet nëpërmjet:
 - *Email-eve* me newsletter informative, ftesa për evente, oferta trajnimesh dhe punësimi,
 - *Rrjeteve sociale* (Facebook, LinkedIn, Instagram) me grupe dhe faqe zyrtare të alumnit,
 - *Website të UV* për alumnit në faqen e universitetit, i cili përmban informacione, njoftime dhe mundësi rrjetëzimi,
 - *Takimeve dhe eventeve fizike* (konferenca, seminare, tryeza, darka për alumnit),
 - *Telefonatave dhe mesazheve* për informacione urgjente ose të rëndësishme.
4. Përfaqësues të alumnit mund të përfshihen në komitete apo këshilla konsultative me Universitetin.

Neni 8

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet UV-së dhe Alumni përfshin:

1. Organizimin e konferencave dhe seminareve dhe aktiviteteve të tjera shkencore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

2. Trajnime dhe workshop-e për zhvillimin e karrierës (aktivitete të Edukimit në Vazhdimësi);
3. Pjesëmarrja e Alumnëve në projekte kërkimore, duke kontribuar me eksperiencën e tyre profesionale.
4. Angazhimin e Alumni-t në mësimdhënie si lektorë të ftuar;
5. Praktika profesionale dhe mbështetje për punësimin e studentëve të rinj;
6. Projekte kërkimore dhe bashkëpunime ndërkombëtare.

Neni 9

Llojet e aktiviteteve me alumnit

1. *Takime vjetore dhe konferenca:* organizim i eventeve ku alumnit ndajnë eksperiencat e tyre dhe lidhen me studentët e rinj.
2. *Programet e mentorimit:* alumnit me përvojë mentorojnë studentët dhe kandidatët në karrierë.
3. *Trajnime dhe workshop-e profesionale:* në bashkëpunim me departamentet akademike.
4. *Projekte bashkëpunimi dhe kërkimore* me alumnit në fushat e interesit të përbashkët.
5. *Nisma për mbështetje sociale dhe humanitare* nga alumnit.
6. *Botime dhe publikime* ku alumnit kontribuojnë me artikuj, histori suksesi, ose materiale edukative.

Neni 10

Detyrimet e Universitetit ndaj Alumnëve

Universiteti "Ismail Qemali" merr përsipër:

1. Ruajtjen e lidhjes me Alumni-n duke mbajtur kontakte të rregullta përmes platformave online të dedikuara ose rrjeteve sociale apo aplikacioneve të veçanta për Alumni-n.
2. Sigurimi i infrastrukturës dhe mjeteve për komunikim dhe ruajtje të të dhënave.
3. Mbajtja e konfidencialitetit të të dhënave personale dhe përdorimi vetëm për qëllime institucionale.
4. Organizimin e aktiviteteve dhe eventeve, takime vjetore, konferenca të ndryshme. Ofrimi i mbështetjes administrative dhe financiare për aktivitetet e alumnit.
5. Ofrimin e mundësive për përfshirje të Alumni-t në jetën universitare duke i ftuar si lektorë dhe mentor të këshillimit profesional.
6. Promovimi i sukseseve të Alumni-t nëpërmjet prezantimit të historive të suksesshme në faqen zyrtare të universitetit si dhe prezantimi i tyre si modele për studentët e rinj.
7. Universiteti mund të krijojë ura bashkëpunimi me Alumni-n për hulumtime shkencore, projekte inovative.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

8. Informimi dhe angazhimi i alumnit në vendimmarrje dhe në zhvillimin e programeve të universitetit kur është e nevojshme.

Neni 11

Detyrat funksionale të Sektorit të Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumnit

A. Shërbime për Alumni

- Krijimi dhe ruajtja e lidhjeve me alumni: SKSSA është përgjegjës për krijimin e një rrjeti të fortë të alumni dhe për ruajtjen e lidhjeve me ta, duke ofruar mundësi për të mbajtur kontakton me universitetin dhe për të kontribuar në zhvillimin e tij.
- Organizimi i aktiviteteve për alumni: Pjesëmarrja dhe mbështetje për organizimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve që angazhojnë alumni, si takime, seminare, nevente sociale dhe aktivitete të tjera që i mundësojnë atyre të lidhen me njëri-tjetrin dhe me universitetin.
- Ofrimi i mundësive për mentorim dhe këshillim: Aktivitetet për krijimin e mundësive për mentorim dhe këshillim të studentëve nga alumni, duke shfrytëzuar eksperiencën dhe njohuritë e tyre për t'i ndihmuar studentët në zhvillimin e karrierës.
- Mbështetje për zhvillimin e mundësive të punës dhe networking për alumni: Nxitja e mundësive të punës dhe angazhimit për alumni, si dhe mundësia për të krijuar kontakte profesionale të dobishme për avancimin e karrierës së tyre.

B. Menaxhimi i Informacionit dhe Burimeve për Studentët dhe Alumni

- Ofrimi i informacionit për mundësitë e karrierës: Krijimi dhe përditësimi i burimeve të informacionit që janë të aksesueshme për studentët dhe alumni, si mundësitë për punësim, praktika, bursat dhe ngjarjet e karrierës.
- Mbështetje për kërkimin e mundësive të financimit: Ofrimi i informacionit dhe asistencës për studentët dhe alumni për mundësitë e bursave, granteve dhe financimit për zhvillimin e karrierës.
- Platforma dhe sisteme online për alumni: Përdorimi i platformave dhe sistemeve të menaxhimit të lidhjeve me alumni për të krijuar mundësi të reja për komunikim dhe zhvillim profesional.

C. Monitorimi i Përshtatshmërisë të Studentëve në Tregun e Punës

- Vlerësimi i suksesit të studentëve pas diplomimit: Monitorimi i rritjes profesionale të studentëve pas përfundimit të studimeve për të vlerësuar se sa mirë janë përgatitur ata për tregun e punës dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësime në programet akademike dhe shërbimet që ofrohen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- b. Raportimi i suksesit dhe realizimeve: Mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi suksesin e studentëve dhe alumni në karrierë dhe përgatitjen e raporteve që mund të përdoren për të përmirësuar shërbimet dhe strategjitë e zhvillimit të karrierës.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet e Alumnit të Universitetit "Ismail Qemali"

1. Alumni ka të drejtë të marri pjesë në aktivitetet që zhvillon Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Përditësojnë të dhënat personale dhe profesionale pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Alumni.
3. Alumni shërben si promovues i universitetit, duke ndihmuar në promovimin e tij në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Alumni merr përsipër mentorimin e studentëve të rinj nëpërmjet një programi të dedikuar duke ndarë përvojat e tyre profesionale dhe duke ofruar udhëzime për karrierën.
5. Alumni ndihmon studentët e diplomuar rishtas për të gjetur punë përmes rrjetëzimit ose duke ofruar praktika në kompanitë ku punojnë.
6. Alumni ndihmon në krijimin e eventeve, konferencave dhe takimeve për të bashkuar komunitetin universitar.
7. Respekton rregullat dhe vlerat e Universitetit në aktivitetet e organizuara.

Neni 13

Përfitimet për Alumnit

1. Akses në informacione dhe njoftime për trajnime, punësim dhe zhvillim profesional.
2. Mundësi për rrjetëzim dhe bashkëpunim me profesionistë dhe akademikë.
3. Përkrahje në organizimin e aktiviteteve dhe promovimin e iniciativave personale.
4. Pjesëmarrje në evente, konferenca dhe aktivitete të universitetit me kushte të favorshme.
5. Çertifikata ose vlerësime për kontributin në zhvillimin e universitetit.

Neni 14

Mbrojtja dhe Siguria e të Dhënave Personale

1. Universiteti merr përsipër të respektojë rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit në fuqi.
2. Të dhënat e alumnit do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në rregullore dhe me pëlqimin e tyre.
3. Alumni kanë të drejtë të kërkojnë fshirjen ose korrigjimin e të dhënave personale në çdo kohë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

KREU III

VLERËSIMI I BASHKËPUNIT DHE DISPOZITAT PËRMBYLLËSE

Neni 15

Monitorimi dhe raportimi

1. Sektori i Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumnit përgatit raporte vjetore për aktivitetet dhe bashkëpunimet me alumnit.
2. Raportet paraqiten në Rektoratin e Universitetit dhe do të përdoren për përmirësimin e politikave dhe programit të alumnit.
3. Një sistem feedback-u nga alumnit, nëpërmjet pyetësorit për ta, do të vlerësojë efektivitetin e komunikimit dhe bashkëpunimit.

Neni 16

Dispozita të fundit

1. Zbatimi i kësaj rregullore i takon Sektorit të Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumnit.
2. Në çdo kohë një përfaqësi e alumnit mund të kërkoj ndryshime në rregullore në bashkëpunim me Sektorin e Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumnit.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Senatin Akademik të UV dhe është e detyrueshme për të gjitha palët.
4. Çdo ndryshim apo plotësim në këtë rregullore bëhet me vendim të Senatit të Universitetit.
5. Për rastet që nuk parashikohen në këtë rregullore, zbatohen aktet ligjore dhe rregullat e tjera të brendshme të universitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SHTOJCA 1 - FORMULAR REGJISTRIMI PËR ALUMNI

Universiteti "Ismail Qemali" Vlore
Zyra e Marrëdhënieve me Alumni
Formular Regjistrimi i Alumni-t

Të dhënat personale:

- Emri dhe Mbiemri: _____
- Data e lindjes: _____
- Numri i telefonit: _____
- Adresa e email-it: _____
- Adresa fizike: _____

Informacion për studimet:

- Fakulteti/Dega: _____
- Viti i diplomimit: _____
- Cikli i studimit (Bachelor, Master, Doktoraturë): _____

Informacion profesional:

- Pozicioni aktual: _____
- Emri i kompanisë/institucionit: _____
- Adresa e punës: _____
- Numri i telefonit profesional: _____
- Email profesional: _____

Preferenca për komunikim:

- Email ()
- Telefon ()
- Rrjetet sociale (p.sh. LinkedIn) ()
- Tjetër (specifiko) _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Interesat për përfshirje:

- Trajnime dhe seminare ()
- Mentorim për studentët ()
- Projekte kërkimore/bashkëpunim akademik ()
- Evente sociale dhe kulturore ()
- Tjetër (specifiko) _____

Deklaratë

Deklaroj që të dhënat e mësipërme janë të sakta dhe lejoj Universitetin "Ismail Qemali" Vlore të përdorë këto të dhëna për qëllime komunikimi dhe bashkëpunimi, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Data: _____ Nënshkrimi: _____